




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref:/1705/406/BA/AH

**Bordi për Ankesa**, i përberë nga Avdyl Hyseni, kryetar dhe Dua Dauti-Kadriu e Musa Dragusha, anëtarë, lidhur me ankesën e parashtruar nga Top Kosova Radio, kundër Vendimit Ref:1609/985/KPM/am, të datës 19.09.2016 të Komisionit të Pavarur për Media, me datën 18.04.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e Top Kosova Radio, dhe mbetet në fuqi Vendimi Ref:1609/985/KPM/am, i datës 19.09.2016 së Komisionit të Pavarur për Media.

### A r s y e t i m

Top Kosova Radio, me datë 29.11.2016 ka parashtruar ankese kundër Vendimit Ref:1609/985/KPM/am, i datës 19.09.2016 së Komisionit të Pavarur për Media, pran Bordit për Ankesa.

Bardi për Ankesa, në seancën e mbajtur me date 18.04.2017, ka shqyrtuar ankesën e Top Kosova Radio, kundër Vendimit Ref:1609/985/KPM/am, të datës 19.09.2016 së Komisionit të Pavarur për Media, me të cilin vendose mos ripërtëritjen e licencës së Top Kosova Radio.

Top Kosova Radio, konsideron se Vendimi i KPM-së, është i pa bazuar në fakte dhe prova dhe është marre në kundërshtim me dispozitat ligjore, sepse nuk përfillen fare njoftimet dhe kërkesat tona paraprake të bëra disa here në drejtim të KPM-së, për revokimin e licencës së dhënë për vitin 2016 për Top Kosova Radio, sepse për shkak të vështirësive teknike dhe financiare nuk kemi mund të vazhdojmë transmetimin e rregullt. Me date 25.04.2016 kemi njoftuar se Top Kosova Radio që nga qershori i vitit 2013, ka kaluar vetëm në radio muzikore, dhe nuk ka pasur asnjë emision informative apo të natyrës tjetër. Gjithashtu e kemi njoftuar KPM-në, edhe për fillimin e procedurës për shuarjen e aktiviteteve të Top Kosova Radio, ku edhe me datën 25.05.2016, është bërë shuarja e kompanisë "Interpres R. Company" sh.p.k pjese e secilës ka qenë Top Kosova Radio.

Përfaqësuesi i KPM-së, deklaroi se në mënyrë të vazhdueshme e kemi njoftuar palën ankuese se kërkesa për heqje dore nga licenca nuk mund të konsiderohet valide për faktin se nuk ane parashtruar nga palët e autorizuara (pronari i subjektit të licencuar dhe kompania me emrin e biznesit të licencuar në KPM). Vendimi i KPM-së, nuk përmban mase sanksionuese, është thjeshtë një vendim procedural përmes të cilit konfirmohet se pala nuk ka parashtruar kërkesë për

vazhdimin e licencës dhe se licenca ekzistuese nuk është me valide. KPM, si rezultat i dështimit të palës ankuese për të parashtruar kërkesën për vazhdim të licencës, ka marre vendim që licenca e palës ankuese të mos vazhdohet, i cili vendim është marre në pajtim me nenin 25 të Ligjit për KPM-në.

Bordi për Ankesa, ka analizuar të gjitha provat dhe ka gjetur se kërkesat për heqje dorë nga licenca e parashtruar nga ana e Top Kosova Radio, në KPM, nuk janë parashtruar nga pronari apo i autorizuari i subjektit të licencuar. Gjithashtu bordi ka konstatuar se Top Kosova Radio, nuk ka parashtruar kërkesë në KPM për vazhdimin e licencës, brenda afatit siç përcaktohet me ligjin për KPM-në, dhe rregullativën përkatëse, pavarësisht njoftimit të vazhdueshëm nga ana e KPM-se. Ne baze të këtyre fakteve bordi konsideron se Vendimi Ref:1609/985/KPM/am, i datës 19.09.2016 së Komisionit të Pavarur për Media, është i bazuar në faktet dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar ne nenin 36 paragrafi 3 i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, vendosi unanimitisht si në diapozitiv të këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi mund të iniciohet konflikt administrative me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.



Avdyl Hyseni  
*(Signature)*  
Kryetar i Bordit për Ankesa